



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202002525/6

Tiranë ___/___/2020

Lënda: *Rekomandohet dërgimi i të paraburgosurës B. G. për vizitë të specializuar dhe garantimi i të drejtës së saj për informim si dhe për të bërë kërkesa/ankesa sipas formës dhe procedurës së përcaktuar në ligj.*

IEVP "ALI DEMI", TIRANË
Drejtorit
Znj. Elona Demollari

E nderuar Znj. Demollari,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë Av. F. Gj., përfaqësuesi ligjor i të paraburgosurës B. G., i cili pretendon se IEVP-ja nuk i ka ofruar shërbim shëndetësor dhe nuk i ka mundësuar një vizitë mjekësore tek mjeku specialist. Përfaqësuesi ligjor na ka vënë në dispozicion kërkesën nr. 16 Prot., datë 16.07.2020 drejtuar IEVP "Ali Demi", ku shprehet nevoja për dërgimin e të paraburgosurës Blerina Gega tek mjeku specialist. Sipas avokatit, kërkesës për vizitë mjekësore, stafi i IEVP-së i është përgjigjur me presion psikologjik dhe provokime ndaj të paraburgosurës duke vënë në dyshim vërtetësinë e shqetësimeve të saj shëndetësore.

Për verifikimin e kësaj ankese kemi kërkuar informacion dhe dokumentacion në institucionin tuaj, kemi administruar kartelën klinike të të paraburgosurës B. G., informacionin që i është dërguar Ministrisë së Drejtësisë për këtë rast nga IEVP "Ali Demi", përgjigjen që i është kthyer nga ana juaj përfaqësuesit ligjor të të paraburgosurës si dhe kemi marrë informacion nga Instituti i Shëndetit Publik lidhur me ofrimin e shërbimit të mamografisë për gratë e burgosura.

Në përgjigjen tuaj, ardhur me shkresën Nr.1072 Prot., datë 03.09.2020 thuhet se, e paraburgosura ka paraqitur gjendje të mirë shëndetësore në datën 29.05.2020 kur është pranuar në IEVP dhe në konsultat periodike që ka patur me mjeken e IEVP-së është shprehur se ndihet e shëndetshme. Vetëm dy muaj më pas ajo është shprehur se ka kryer para disa vitesh ekzaminime dhe konsulta për gjirin. Të paraburgosurës i është kërkuar të vërë në dispozicion dokumentacionin shëndetësor, në mënyrë që të njihet saktësisht gjendja e saj shëndetësore si dhe për të përcaktuar ndjekjen në vijimësi. Familjarët e të paraburgosurës kanë vënë në dispozicion vetëm një "echo mamme". Inspeksioni i gjirit

dexter ka rezultuar i padhimbshëm edhe pse e paraburgosura fillimisht është shprehur se ndjente dhimbje.

Në informacionin më të detajuar që institucioni juaj i ka dërguar Ministrisë së Drejtësisë me shkresën Nr.989/1 Prot., datë 06.08.2020, përveç sa më lart, në mënyrë të përmbledhur thuhet se: në datën 21.07.2020 e paraburgosura B. G. ka depozituar në IEVP një kërkesë për vizitë mjekësore në spitalin onkologjik me Dr. A. K.. Po në këtë datë është realizuar konsultë me mjeken e institucionit ku të paraburgosurës i është kërkuar një anamnezë e hollësishme si dhe dokumentacion rreth patologjisë së referuar. E paraburgosura nuk është treguar bashkëpunuese, por është revoltuar duke kërkuar me ngulm t'i caktohet një vizitë si dhe ka përdorur tone të larta e fjalë kërcënuese. Në datën 22.07.2020 mjekja e IEVP-së ka marrë takim me vajzën dhe mbesën e të paraburgosurës, të cilat janë interesuar për gjendjen shëndetësore të familjares së tyre dhe për çfarë ato duhet të bënin që e paraburgosura të arrinte të kryente një konsultë specialist jashtë institucionit (spital shtetëror ose privat). Familjarëve u është kërkuar të sjellin dokumentacionin shëndetësor si dhe janë sqaruar se në vazhdim është një komision që bën vlerësimin e gjendjes, aq më tepër për shkak të situatës pandemike, situatë për të cilën duhet treguar shumë kujdes për shëndetin e të burgosurave.

Në datën 23.07.2020, mjekja e institucionit ka marrë takim me të paraburgosurën, e cila sërish nuk është treguar bashkëpunuese duke u revoltuar nga pyetjet lidhur me gjendjen shëndetësore. Mjekja ka mundur të kryejë inspektim/palpim të gjirit dexter, vendi ku e paraburgosura referonte për gjendra, ku nuk u konstatua dhe nuk u referua nga pacientja dhimbje. Në përgjigje të kërkesës për të kryer konsultë jashtë institucionit, e paraburgosura u sqarua për pamundësinë e kryerjes së kësaj vizite për parandalimin e përhapjes së Covid-19 si dhe i është cituar udhëzimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për të shmangur dërgimin e të burgosurave për konsulta apo ekzaminime në spitale publike dhe private, përveç urgjencave mjekësore. Po në datën 23.07.2020, familjarët e të paraburgosurës kanë vënë në dispozicion një echo mamme të realizuar në Spitalin Amerikan që mban datën 29.10.2018, pa firmën dhe vulën e mjekut. Në datën 29.07.2020, e paraburgosura B. G. ka depozituar në postën e institucionit një kërkesë “vizitë nga mjeku, ku mund t'i bëj vizitë në institucion”. Lidhur me këtë kërkesë, e paraburgosura është sqaruar për procedurën sipas së cilës, familjarët duhet të paraqesin kërkesën e mjekut/spitalit privat për të vizituar pacienten duke përcaktuar datën dhe orën. Kjo kërkesë do të dërgohej më pas për shqyrtim, në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

Po ashtu në informacionin tuaj sqaroni se në kushte normale, nga referimi i të problemit shëndetësor, kryhet monitorimi i situatës shëndetësore të pacientit, bëhet vlerësimi dhe vendosen rekomandimet sipas nevojës. Çdo pacient kur kryen konsultë, ekzaminime apo shtrime në qendra të specializuara shtetërore apo private, pajiset me dokumentacion shëndetësor, sidomos me patologji sinjifikative. Insistimi i mjekes së IEVP-së në këtë rast ka ardhur si pasojë e shqetësimit të pa referuar më parë nga e paraburgosura në anamnezën fillestare. Shërbimi shëndetësor i përgjigjet çdo kërkesë të arsyetuar të të paraburgosurve dhe të dënuarve, që lidhet me shëndetin e tyre dhe në mënyrë periodike ushtron kryesisht kontrolle mjekësore për gjendjen e përgjithshme.

Ndërsa, nga këqyrja e kartelës klinike ndër të tjera rezulton, se mjekja i IEVP-së ka shënuar referimet në datat e lartpërmendura si dhe shqetësimin që është paraqitur për herë të parë nga e paraburgosura në datën 14.07.2020 ku shënohet:

“Aktualisht pacientja ankon për dhimbje gjiri dexter, për të cilën sqaron se ka gjendra. Është vizituar tek mjeku specialist Dr. A. K. dhe ka kryer një sërë ekzaminimesh. Iu kërkua të vendosi në dispozicion të institucionit kopje të dokumentacionit që disponon. Gjithashtu sqaron se është në ditët e para të ciklit menstrual, gjë që është normale të japë dhimbje gjoksi. U këshillua të vejë në dijeni stafin shëndetësor për çdo ndryshim në gjendjen shëndetësore të saj. Parametrat vital në normë”.

Meqenëse ankesa e të paraburgosurës kishte të bënte me mosofrimin e shërbimit shëndetësor dhe mosmundësimin e një vizite mjekësore tek mjeku specialist lidhur me shqetësimet e gjirit u interesuam edhe në Institutin e Shëndetit Publik për të na informuar¹ lidhur me ofrimin e shërbimit të mamografisë për gratë e burgosura. Në përgjigjen² që kemi marrë thuhet se:

“Çdo vit në muajin Tetor Ministria e Shëndetësisë bën kërkesë pranë Ministrisë së Drejtësisë, për kryerjen e shërbimit të mamografisë depistuese për gratë e burgosura të IEVP “Ali Demi”, me njësinë e lëvizshme në ISHP, në ditë të caktuara paraprakisht. Ky shërbim ofrohet bazuar mbi këtë komunikim të përvitshëm.

Shërbimi i mamografisë për depistimin e grave të burgosura pa shenja klinike, kryhet periodikisht në muajin Tetor të çdo viti që prej vitit 2015. Ky shërbim ofrohet për gratë e shëndetshme me qëllim identifikimin e hershëm të kancerit të gjirit.

Për kërkesa të veçanta, kur ka shqetësime klinike dhe ka nevojë për diagnostikim, trajtim dhe ndjekje mjekësore, ndiqet praktika e referimit në Sistemin Shëndetësor (Spitale). ISHP nuk është pjesë e kësaj praktike.

Mjeku i familjes sipas kontratës me Fondin e Sigurimeve, në paketën e shërbimeve që ofron, duhet të kryejë ekzaminimin klinik të gjirit, dhe të japi rekomandimet për të kryer ekzaminim të mamografisë për depistim në gratë e moshave mbi 50 vjeç, në sistemin shëndetësor. Njësitë e lëvizshme të mamografisë, ofrojnë shërbime depistuese profilaktike në zonat ku ka vështirësi aksesi në mamografi.

Shërbimet e mësipërme, bazohen në urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr.284, datë 02.07.2015³.”

Për të vlerësuar veprimet/mosveprimet e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve penale “Ali Demi”, lidhur me ankesën e të paraburgosurës B. G., që na është përcjellë nëpërmjet përfaqësuesit të saj ligjor, i jemi referuar legjislacionit në fuqi në kohën kur e paraburgosura ka paraqitur kërkesë për të kryer një vizitë te mjeku specialist, Programit Kombëtar të Kontrollit të Kancerit 2011-2020 dhe informacionit të dhënë nga Instituti i Shëndetit Publik. Gjithashtu me vlerë në këtë drejtim është edhe Ligji Nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” që ka hyrë në fuqi në datën 07.08.2020 (ligji aktual).

Në Ligjin Nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, garantohet e drejta e të burgosurit për të paraqitur kërkesa. Kështu në nenin 8, paragrafi i parë parashikohet se:

Të paraburgosurit dhe të dënuarit kanë të drejtë të paraqesin kërkesa dhe të bëjnë ankime lidhur me zbatimin e ligjit dhe rregullave të brendshme në formën që përcaktohet në këtë ligj dhe në mënyrë individuale.

¹ Shkresa me Nr.K2/A24-4 Prot., datë 17.09.2020.

² Shkresa me Nr.1063/1 Prot., datë 22.09.2020.

³ Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë Nr.284, datë 02.07.2015 “Për miratimin e Udhëzuesit mbi depistimin dhe kapjen e hershme të kancerit të gjirit në shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor”.

Ndersa në nenin 49, paragrafi i katërt, të tij përcaktohet:

Kërkesat ose ankesat, pasi regjistrohen në një regjistër të veçantë, i dorëzohen drejtorit të institucionit, i cili ngarkon punonjësin përkatës për zgjidhjen dhe kthimin e përgjigjes të paraburgosurve dhe të dënuarve.

Gjithashtu e drejta e të burgosurit për të paraqitur kërkesa garantohet edhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve⁴ si më poshtë vijon:

Neni 23/7/e

7. Gjatë qëndrimit në institucion të dënuarit dhe të paraburgosurit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kanë këto të drejta:

e) Të paraqesin kërkesa dhe ankesa te personeli i I EVP-së dhe i çdo institucioni tjetër;

Neni 25

1. Kërkesat dhe ankesat bëhen sipas përcaktimeve të ligjit për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve.

2. Çdo institucion mban dhe përditëson regjistrin e kërkesave ose ankesave të të dënuarve dhe të të paraburgosurve, në formë shkresore dhe elektronike. Formati dhe përmbajtja e regjistrit është sipas aneksit nr. 1, që bashkëlidhet kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

Referuar dokumentacionit që kemi administruar rezulton se e paraburgosura B. G. ka paraqitur kërkesë verbale për t'u vizituar nga një mjek specialist si dhe dy kërkesa me shkrim që janë protokolluar në I EVP. Familjarët e të paraburgosurës kanë paraqitur kërkesë verbale për t'u njohur me procedurën që duhet të ndiqet në mënyrë që të realizohej një konsultë specialisti në një spital shtetëror ose privat. Gjithashtu, edhe përfaqësuesi ligjor i të paraburgosurës ka paraqitur kërkesë me shkrim në I EVP për të mundësuar vizitë të specializuar mjekësore me shpenzimet e saj.

Mjekja e I EVP-së ka marrë takim me të paraburgosurën për të kuptuar gjendjen e saj shëndetësore si dhe ka kërkuar të njihet me dokumentacionin që kishte të bënte me vizitat e referuara nga e paraburgosura. Por, kërkesës të të paraburgosurës dhe familjarëve të saj për të kryer një vizitë të specializuar i është kthyer vetëm përgjigje verbale. Të paraburgosurës i është komunikuar se kryerja e vizitës jashtë I EVP-së është e pamundur për arsye të situatës së krijuar nga virusi Covid-19 si dhe i është cituar udhëzimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për të shmangur dërgimin e të burgosurave për konsulta apo ekzaminime në spitale publike dhe private, përveç urgjencave mjekësore. Familjarët janë vënë në dijeni për këtë kufizim si dhe janë sqaruar për procedurën sipas së cilës, ata duhet të paraqesin kërkesën e mjekut/spitalit privat për të vizituar pacienten duke përcaktuar datën dhe orën dhe më pas kërkesa do të dërgohej në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Ndërsa në përgjigjen me shkrim që i është kthyer përfaqësuesit ligjor me shkresën Nr.916 Prot., datë 23.07.2020 nuk jepen sqarime lidhur me kufizimet e vendosura për shkak të pandemisë dhe procedurën që duhet të ndiqet nga familjarët për të realizuar vizitën mjekësore jashtë I EVP-së në një klinikë private. Në këtë përgjigje thuhet se pacientes i janë realizuar konsulta me kërkesë të mjekes së I EVP-së, ku vetëm së fundi

⁴ VKM Nr. 437, datë 20.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve".

ajo ka referuar për shqetësime në gjirin dexter dhe se ajo nuk ka venë në dispozicion dokumentacionin lidhur me konsultën onkologjike që kishte kryer para 3 vitesh.

Ne vlerësojmë se nga stafi i IEVP “Ali Demi”, në trajtimin e kërkesave të ankueses nuk është ndjekur procedura e parashikuar në ligj, për të administruar kërkesat/ankesat sipas formatit të caktuar si dhe dhe regjistrimin e tyre në regjistrin e kërkesave ose ankesave të të dënuarve dhe të të paraburgosurve (në formë shkresore dhe elektronike). Po kështu, nuk është përmbushur detyrimi për ta informuar të paraburgosurën në lidhje me formën e kërkesës (me shkrim) për vizitë tek mjeku specialist si dhe e të drejtës për të paraqitur ankim lidhur me zbatimin e ligjit dhe rregullave të brendshme në formën e përcaktuar në ligj.

Për sa i përket trajtimit shëndetësor të të paraburgosurës B. G., në rastin në fjalë kërkesës për të realizuar një vizitë mjekësore tek mjeku specialist (spital shtetëror ose privat), i referohemi legjislacionit në këtë drejtim. Një dokument i rëndësishëm strategjik është Programi Kombëtar për Kontrollin e Kancerit si një produkt i bashkëpunimit të institucioneve shqiptare me organizmat ndërkombëtarë për të trajtuar ndër të tjera edhe problemin e “Sëmundjeve jo të Transmetueshme” e cila përfshin kancerin. Gjithashtu përmendim marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë e Shëndetësisë për ofrimin e shërbimit të mamografisë për të arritur rezultatet më të mira të mundshme për zvogëlimin e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë nga kanceri.

Më konkretisht, në Ligjin nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, përcaktohet se⁵:

“Të paraburgosurit dhe të dënuarit mund të kërkojnë që të vizitohen, me shpenzimet e tyre, nga një mjek që duan ata.

Shërbimi shëndetësor duhet të sigurojë:

1. Parandalimin, diagnostikimin dhe mjekimin e sëmundjeve;

Për rastet e sëmundjeve ngjithëse ose sëmundjeve të tjera, diagnostikimi dhe mjekimi i të cilave nuk mund të sigurohen në kushtet e institucionit, të paraburgosurit dhe të dënuarit transferohen në spitalin e burgjeve dhe, kur është e nevojshme, ata transferohen në spitalin e burgjeve dhe, kur është e nevojshme, ata transferohen në Qendrën Spitalore Universitare, Tiranë e në institucionet spitalore, në rang qarku apo rrethi, në varësi të saj.”

Ndërsa, në VKM Nr.437, datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, parashikohet si më poshtë, vijon:

Neni 23, pika 7/dh

7. Gjatë qëndrimit në institucion të dënuarit dhe të paraburgosurit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kanë këto të drejta:

dh) T’u sigurohet shërbimi mjekësor 24-orësh, nën kujdesin e personelit mjekësor në bashkëpunim me spitalin e burgjeve dhe me organet shtetërore përkatëse të shëndetësisë, si dhe të bëjnë vizita privatisht me shpenzimet e tyre.

⁵ Neni 33, paragrafi i pestë, paragrafi i gjashtë pika 1 dhe paragrafi i dhjetë.

Neni 73 pika 1

1. *Kujdesi shëndetësor i grave të dënuara apo të paraburgosura ofrohet mbështetur në nevojat specifike gjinore dhe përfshin kontroll të plotë për të përcaktuar nevojat e kujdesit shëndetësor parësor.*

Neni 106 pika 2

2. *Të paraburgosurit apo të dënuarit i lejohet që, me shpenzimet e veta, të kryejë vizita dhe mjekime të specializuara në klinika të tjera jashtë institucionit, me miratimin e drejtorit të IEVP-së.*

E paraburgosura B. G. ka bërë kërkesë, fillimisht verbalisht dhe më pas me shkrim, për të kryer vizitë te mjeku specialist për arsye se ka ndërje dhimbje në gjirin e djathtë duke e lidhur këtë shqetësim me konkluzionet që ka nxjerrë radiologu i një spitali privat pas ekzaminimit radiologjik të gjirit që ka kryer në vitin 2018. “*Echo mamme*” që familjarët e të paraburgosurës i ka vënë në dispozicion IEVP-së mban vulën e Spitalit _____ në Durrës dhe ka disa të dhëna për pacienten B. G., si numër referimi, datën 29.10.2018, konkluzionet e radiologut, por nuk ka të shënuar emrin e radiologut dhe vulën e tij. Në echo ndër të tjera shkruhet:

“Mame dexter:

....

.....

Konkluzion:

Rekomandohet: Konsulta me mjekun Kirurg-Senolog”.

Mjekja e IEVP-së ka marrë takim me të paraburgosurën për të kuptuar gjendjen e saj shëndetësore si dhe ka kërkuar të njihet me dokumentacionin që kishte të bënte me vizitat e referuara nga e paraburgosura. Mjekja shpjegon se, inspeksioni i gjirit dexter ka rezultuar i padhimshëm dhe nga palpimi i vendit ku e paraburgosura referonte për gjendra, nuk u konstatua dhe nuk u referua nga pacientja dhimbje. Familjarët e të paraburgosurës nuk kanë vënë në dispozicion dokumentacion tjetër përveç “*echo mamme*” që nuk kishte emrin dhe vulën e radiologut dhe vetë e paraburgosura nuk është treguar bashkëpunuese kur i janë bërë pyetje lidhur me shqetësimet shëndetësore. Për këto arsyeja mjekja e IEVP-së ka vlerësuar se nuk ishte nevojshme dërgimi i të paraburgosurës për të kryer një vizitë te mjeku specialist. Atëherë e paraburgosura është detyruar të kërkojë nëpërmjet përfaqësuesit ligjor që të kryejë vizitë me shpenzimet e veta. Në përgjigjen me shkrim që i është kthyer përfaqësuesit ligjor⁶ evidentojmë se nuk jepen sqarime lidhur me procedurën që duhet të ndiqet në mënyrë që e paraburgosura të realizojë vizitë mjekësore jashtë IEVP-së me shpenzimet e veta megjithëse në informacionin që IEVP i ka dërguar Ministrisë së Drejtësisë thuhet se familjarët janë sqaruar për procedurën.

Pavarësisht faktit që e paraburgosura nuk ka referuar probleme kur është pranuar në IEVP dhe nuk është treguar bashkëpunuese lidhur me shqetësimin e saj, konkluzioneve të

⁶ Shkresa me Nr.916 Prot., datë 23.07.2020 “Kthim përgjigje kërkesës suaj Nr.896 Prot. datë 20.07.2020”.

radiologut të bëra në vitin 2018 duhet t'u ishte dhënë rëndësi edhe pse ndodh që një pacient mund të neglizhohet rekomandimet e mjekut deri sa një problem të bëhet serioz. Në informacionin që IEVP "Ali Demi" i ka dërguar Ministrisë së Drejtësisë thuhet se, kur vajzës të të parburgosurës iu bë me dije se e ëma nuk kishte paraqitur më parë shqetësime ajo është përgjigjur "Ashtu është mami, nuk tregon, se kujton se do t'i kalojë të gjitha vetë".

Pikërisht për t'i dhënë theksin e duhur parandalimit dhe zbulimit të hershëm të sëmundjeve tumorale janë zhvilluar një sërë programesh kombëtarë. Ministria e Shëndetësisë si një nga aktorët kryesorë në këtë drejtim i ka kushtuar rëndësi parandalimit dhe zbulimit të hershëm të kancerit të gjirit përmes fuqizimit të shërbimit shëndetësor në fushën e kontrollit të kancerit, veçanërisht në diagnozë dhe trajtim. (informimit, edukimit dhe trajnimit të punonjësve të shëndetësisë lidhur me ekzaminimin klinik të gjirit).

Parimi i parandalimit të kancerit shtjellohet më në hollësi në Programin Kombëtar të Kontrollit të Kancerit, nga i cili citojmë:

"Të paktën një e treta e të gjithë kancereve mund të parandalohet nëpërmjet një kontrolli të faktorëve të rrezikut. Kanceret e së nesërme janë të parandalueshme sot, prandaj, parandalimi parësor i kancereve të së ardhmes është tashmë një përparësi absolute".

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë ofron çdo vit në muajin Tetor, shërbimin e mamografisë për depistimin e grave të burgosura pa shenja klinike me qëllim identifikimin e hershëm të kancerit të gjirit. Ky informacion nuk i është dhënë as të parburgosurës dhe as përfaqësuesit të saj ligjor, të cilët duhet të ishin vënë në dijeni të mundësisë së kryerjes së një ekzaminimi pa shpenzime. IEVP-ja duhet t'i kishte dhënë rëndësinë e duhur parimit të parandalimit të kancerit të gjirit dhe të kishte marrë masa për dërgimin e të parburgosurës B. G. te mjeku specialist qoftë edhe me shpenzimet e saj, si një e drejtë e garantuar nga ligji.

Gjithashtu, një tregues i vëmendjes së shtuar për parandalimin dhe kapjen e hershme të kancerit të gjirit, është risia e sjellë në Ligjin e ri Nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të parburgosurve". Në ndryshim nga ligji i mëparshëm, është parashikuar një garanci e re për kontrollin periodik të grave të burgosura për parandalimin dhe diagnostikimin e sëmundjeve të kancerit të gjirit.

Kështu, në nenin 42/6 "Shërbimet e kujdesit shëndetësor për kategori të veçanta", parashikohet:

6. "Në rastin e grave të burgosura, institucioni siguron kontrollin periodik nga mjeku gjinekolog, mjeku psikiatër dhe kontrole periodike për parandalimin dhe diagnostikimin e sëmundjeve të kancerit të gjirit dhe sëmundjeve të tjera për gratë."

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut" si dhe në mbështetje të nenit 21/b të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" i ndryshuar ku përcaktohet se: "Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së

shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave të menjëhershme nga Institucioni i Ekzekutimit të Dënimeve Penale “Ali Demi”, për dërgimin e të paraburgosurës B. G. për vizitë te mjeku specialist në një spital shtetëror ose privat, në lidhje me shqetësimin që ajo ka.
- Garantimi i të drejtës për informim si dhe për të bërë kërkesa/ankesa të të burgosurave sipas formës dhe procedurës së përcaktuar në ligj.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*" i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi